

Në përputhje me Ligjin për arsimin e lartë (Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 82/18, 178/21, 58/24), Statutin e Universitetit të Tetovës, Statutin e Fakultetit të Arteve dhe Udhëzuesin me kriteret për realizimin e zgjedhjeve për anëtarët dhe për kryetarin e Kuvendit Studentor të Fakultetit të Arteve, shpallet:

KONKURS
për paraqitjen e kandidatëve për zgjedhjen e anëtarëve dhe të kryetarit
të Kuvendit Studentor të Fakultetit të Arteve

- I. Të drejtë për të aplikuar kanë të gjithë studentët që e kanë regjistruar semestrin veror në vitin akademik 2025/2026, duke përfshirë edhe studentët që kanë regjistruar semestër veror të zbrazët në vitin akademik të lartpërmendur.
- II. Së bashku me Fletaplikimin (formularin), kandidatët dorëzojnë:
 - biografi (CV),
 - vërtetim nga shërbimi për çështje studentore se kandidati e ka regjistruar semestrin veror në vitin akademik 2025/2026,
 - vërtetim për notë mesatare prej së paku 8 për kandidatin për kryetar, i cili do të zgjidhet në mbledhjen e parë të Kuvendit Studentor të Fakultetit.
- III. Kandidatët për zgjedhjen e anëtarëve dhe të kryetarit të Kuvendit Studentor të Fakultetit janë të detyruar që personalisht t'i dorëzojnë fletaplikimet me dokumentet përkatëse, përmes arkivit të Fakultetit ose me postë në adresën: rr. "Ilindenska", p.n., 1200, Tetovë, brenda afatit prej 7 (shtatë) ditëve nga shpallja e njoftimit, respektivisht më së voni deri më 26. 06.2026 në ora 16:30.
- IV. Aplikimet e vonuara dhe të pakompletuara nuk do të shqyrtohen.



Kryetar i Komisionit Zgjedhor

[Handwritten signature]